




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr 631/1prot.

Shkodër, më 7.10.2022

Nr. 5030/1 Prot

Dt. 11.10.22



**LËNDA: Mbi vendimin Nr.60 datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**



Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullore së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, neni 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54 shkronja e/1, neni 55 pikat 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet” neni 25/1/a, VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, pika 49, shtojcës nr.47, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë.9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shyrimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjorë dhe kullor publik”, pika 2 germa a, dhe pika 7, VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, dokumentacionin shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkia Vau-Dejës datë 23.09.2022 dërguar nga Sekretari i Këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.5022prot datë 28.09.2022 u shqyrtua VKB Nr.60 datë 23.09.2022 Vau-Dejës “Për dhënie në përdorim me afat 10-vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 1.161 ha të ekonomisë pyjore Gomsiqe (ngastra nr.41) “Për qëllime pushimi, argetimi, shëndtësore, shoqërore dhe veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedisë sportive, shplohëse, kulturore etj<sup>1</sup>”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim konform procedurave të mëtejshme ligjore, duke bërë përditësim të tarifave të reja sipas ndryshimeve ligjore miratuar me VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore”, pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit publik nga Autoriteti Publik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda SINGONI**



<sup>1</sup> Elementi i rinovimit është pjesë e dispozitave të kontratës gjatë zbatimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 60 datë 23.09.2022

**“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjecar sipërfaqen pyjore prej 1.161 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”, dhe bën pjesë në ngastrën nr.41 në ekonomine pyjore Gomsiqe.**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë të cilësuar votash.**

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes **1.161** ha për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj” qe bën pjese në **ngastrën nr.41** në ekonomine pyjore **gomsiqe**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjete) vjet me te drejte rinovimi.
3. Tarifat e dhenjes me qira duhet të vendosen në kontratë pas konkurimit publik sipas VKM-së **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Shtojca 1, pika 8/3.
4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
5. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**K R Y E T A R**

**Mark Bisha**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Ardian Çelepija**

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 28.09.2022